


Vetting



Qytetarë!
Ngrini Zërin!



DENONCO!

Fletëpalosje

Për bashkëpunimin e
qytetarëve me organet e
Vettingut

VETTINGU KËRKON ANGAZHIMIN AKTIV TË QYTETARËVE

Nisma e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, me mbështetje të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë synon:

- Angazhim aktiv të shoqërisë civile dhe publikut në monitorimin dhe nxitjen e zbatimit të Vettingut.
- Monitorimin me ekspertizë profesionale vendase dhe të huaj, të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
- Nxitjen e transparencës dhe llogaridhënies së organeve të Vettingut, duke publikuar gjetjet e monitorimit, pas ndjekjes së seancave të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

QYTETARË! NDIHMONI NË PROCESIN E VETTINGUT!

Ligji ju ka dhënë një rol të rëndësishëm për të ndihmuar në procesin e vetting-ut.

Mos mendoni se organet e rivlerësimit ose ndërkombëtarët mund të bëjnë ndonjë gjë pa informacionin dhe kontributin tuaj.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ofron asistencë ligjore profesionale për çdo person që ka probleme me prokurorinë dhe gjyqësorin.

PROKURORI NUK HETOI NË MËNYRË TË PLOTË DHE TË GJITHANSHME - RAPORTO!

Nëse prokurori nuk ka hetuar në mënyrë të plotë, të paanshme dhe të gjithanshme, ky mund të jetë një tregues për korrupsion ose sjellje joprofesionale. Prokurori ka vendosur mos fillimin e ndjekjes penale apo ka pushuar akuzën ose çështjen, në mënyrë jo të drejtë, duke mos hetuar në mënyrë objektive, atëherë ju mund të drejtoheni organeve të vettingut. Kontaktoni stafin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit për t'ju asistuar me ndihmë ligjore falas!

PROCESI JUAJ GJYQËSOR ËSHTË I PAKUPTIMTË? GJYQTARI KA SHKELUR LIGJIN? - RAPORTO!

Vettingu largon gjyqtarët dhe ndihmësit e tyre, të cilët kanë demonstruar një cilësi të papranueshme pune, të cilët nuk i kanë respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse ose të viktimave, ose kanë kryer shkelje të tjera procedurale.

Ju mund të raportoni vendimet gjyqësore, të cilave i mungon arsyetimi logjik, që janë të dobëta, pa lidhje, pa cilësi, ose të pambështetura në prova dhe fakte.

Ju mund të raportoni shtyrjen e shpeshtë të seancave në mënyrë të paarsyeshme apo e kanë zvarritur procesin tuaj gjyqësor.

Ju mund të raportoni rastet e papajtueshmërisë dhe konfliktet e interesit të gjyqtarëve që kanë gjykuar çështjen tuaj.

Këto aspekte të lidhura me aftësitë profesionale, mund të jenë tregues të korrupsionit të gjyqtarëve.

Kontaktoni me stafin e KSHH-së për ndihmë ligjore falas!

KUJDES!

Organet e vettingut nuk janë gjykata apeli apo instanca rishikuese. Fakti që keni humbur një çështje civile, penale apo administrative nuk është i mjaftueshëm.

Organet e vettingut nuk mund të korrigojnë rezultatin e çështjes, por në rrethana të caktuara mund të dalin fakte të reja për rishikim të vendimeve.

Drejtoheni pranë zyrave të KSHH-së për më shumë asistencë dhe ndihmë ligjore falas.

RAPORTO!

PRO-DREJTËSIS!



Thuaj JO RYSHFETIT!

**I KAM DHËNË RYSHFET NJË
GJYQTARI - KËRKOJA TË T'I
KTHEJË!**

Vettingu largon nga sistemi gjykatësit dhe prokurorët e korruptuar si dhe ndihmësit e tyre.

Zakonisht, është e vështirë të zbulosh korrupsionin, pasi të dyja palët e përfshira kryejnë një vepër penale.

Ligji i vettingut hapi një derë të pashoqe me nenin 45 për ata që duan të bashkëpunojnë me drejtësinë.

Nëse ju keni korruptuar një gjykatës ose prokuror dhe nëse jeni të gatshëm të denonconi, **ju vetë mundet të mos ndiqeni penalisht**, nëse merrni statusin e bashkëpunëtorit.

Përveç kësaj, mund të kërkonti t'ju kthehen paratë tuaja!

Kjo vlen për të gjitha rastet korruptive nga data **1.1.2006** e deri më sot.

Në rast se keni dhënë ryshfet për të shmangur dënimin për një vepër penale, mund të parashkruhet sot.

Ju rekomandojmë të kërkonti këshilla ligjore falas, duke kontaktuar me KShH-në.

NE DO TË RUAJMË ANONIMATIN TUAJ!

RRETH NESH

Misioni i KSHH është të kontribuojë për respektimin e të drejtave të njeriut, forcimin e shtetit të së drejtës, si dhe zhvillimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme, në përputhje me Kushtetutën dhe me aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

KSHH beson dhe punon për arritjen e një faze zhvillimi të shoqërisë shqiptare ku qytetarët, pavarësisht nga veçoritë, ose dallimet midis tyre ushtrojnë lirisht dhe në mënyrë të njëjtë të drejtat dhe liritë e tyre themelore, në përputhje me standardet kushtetuese dhe ato ndërkombëtare, në të gjitha aspektet e jetës.

KSHH beson se përparimi në mbrojtjen, promovimin dhe respektimin në praktikë të të drejtave të njeriut realizohet përmes angazhimit dhe bashkëpunimit konstruktiv mes qytetarëve, si dhe mes tyre dhe institucioneve të tjera publike, private dhe jofitimprurëse që besojnë në këtë vizion.

KONTAKT



KONTAKTO KSHH NË ADRESËN:

Rr. "Brigada e VIII",
Pall Tekno Projekt,
Shk.2, Kati 6, Ap 10.
Kutia Postare: 1752,
Tiranë, Shqipëri
Mob: 068 20 23 699
Tel: +355 422 33 671
E-mail: office@ahc.org.al
Website: www.ahc.org.al

Deklarimi i të dhënave personale dhe sensitive gjatë trajtimit të ankesave bëhet me vullnet të lire të ankesuesit. Pëlqimi i personit për plotësimin e të dhënave dhe transmetimin e tyre në rrugë institucionale bëhet mbasi punonjësi që merr ankesën i lexon atij/asaj përmbajtjen e formularit tip të ankesave të KShH-së dhe ankesi firmos në fund të formularit. Të dhënat e ankesuesit do të mbahen në përputhje me ligjin nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe Rregulloren e brendshme të organizatës